



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

Njoftim për mediat

“Disa shqetësime për mirëfunktionimin e tregut të prodhimit dhe tregtimit të bukës në Qarkun e Korçës”

Autoriteti i Konkurrencës, bazuar në informacionin e marr nga media mbi rritjen e çmimit të bukës të njoftuar në emër të shoqatës së prodhuesve të bukës të Qarkut të Korçës, vendosi për hapjen e hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në Qarkun e Korçës, për të vërtetuar ekzistencën ose jo të një marrëveshje të ndaluar në kuptim të Ligjit “Për mbrojtjen e Konkurrencës”.

Në vazhdim të procedurave inspektorët e autoritetit realizuan inspektime të menjëhreshme në terren. Gjithashtu, Komisioni i Konkurrencës organizoi një seancë me prodhuesit kryesorë të bukës në këtë Qark. Organizimi i seancës u bë me qëllim identifikimin e faktorëve që ndikojnë në nivelin e konkurrencës në tregun përkatës objekt hetimi. Nga inspektimet dhe sipas deklarimeve të prodhuesve të bukës masive, që morren pjesë në seancë, u konstatua se nuk ekziston një shoqatë vetëm për bukëpjekësit, por ka një shoqatë për Bizneset e Vogla. Gjithashtu, çmimi i këtij produkti në raport me peshën është më i ulët i krahasuar me rrethet e tjera të Shqipërisë.

Pjesëmarrësit deklaruan se pas inspektimeve dhe njohjes me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës u angazhuan që të veprojnë në mënyrë të pavarur në treg. Ndërmarrjet janë treguar shumë bashkëpunuese me Autoritetin e Konkurrencës në realizimin e procedurës hetimore.

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d) dhe 45 paragrafi 2, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, vendosi mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në Qarkun e Korçës si dhe pranimin e angazhimeve të palëve për rivendosjen e konkurrencës në treg. Për të siguruar respektimin e angazhimeve të palëve Autoriteti i Konkurrencës do të monitorojë në vazhdim, tregun e bukës në Qarkun e Korçës

Komisioni i Konkurrencës përfiton nga rasti për të falënderuar Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Korçë, për bashkëpunimin.

Duke marrë shkas nga kjo ngjarje, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të Politikës dhe Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” kërkon të ndërjegjësojë të gjitha shoqatat e biznesit që në veprimtarinë e tyre të mbrojnë interesat e antarëve sipas ligjit dhe të mos

ndikojnë në vendosjen e praktikave të bashkërenduara/të koordinuara për rritje të menjëhershme të çmimeve, fiksimit çmimesh apo ndarje tregu.

Sqarojmë se në kuptim të nenit 3 pika 4 dhe nenit 4 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” marrëveshjet e ndaluara janë shkelja më e rëndë dhe sjellja më antikonkurruese dhe mund të ndëshkohet nga Komisioni i Konkurrencës me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore. Autoriteti i Konkurrencës fton edhe një herë shoqatat e biznesit për rritjen e bashkëpunimit në realizimin e misionit të tij për vendosjen dhe ruajtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Për çdo ankesë, kërkesë për informacion apo kërkesë për bashkëpunim në zbulimin e ndonjë shkelje të ligjit të konkurrencës, jeni të lutur të vizitoni faqen tonë të internetit www.caa.gov.al, dërgoni email në competition@caa.gov.al, fax: +355 4 2234497, tel +355 4 2234504 ose të paraqiteni pranë autoritetit të Konkurrencës në adresën rr. Sami Frashëri, nr.4, Kati IV, Tiranë.

Organizatave e Biznesit, duhet të kenë kujdes në disa drejtime në mënyrë që të zbatojnë ligjin për mbrojtjen e konkurrencës.

1. Gjatë shkëmbimit të informacionit ose studimeve të tregut, organizatat e biznesit duhet të kenë kujdes që të mos lejojnë identifikimin e të dhënave konfidenciale që lidhet me ndërmarrjet individuale si çmimi, pjesët e tregut, burimet e furnizimit etj. në mënyrë që të shmangen marrëveshjet dhe praktikave të bashkërenduara.
2. Në rast se anëtarët e organizatave të biznesit arrijnë një marrëveshje e cila shkel konkurrencën gjatë një mbledhjeje të organizatës si p.sh. fiksimit çmimi, fiksimit i kuotave të prodhimit fiksimit i kushteve të tregtimit ndarja e tregut, bojkotet në grup, fiksimit i çmimit të rishitjes etj, qoftë edhe në mënyrë spontane organizata, drejtuesit e saj dhe anëtarët mund të gjobiten. Në këtë mënyrë, organizatat e biznesit duhet të shmangin çdo lloj deklarate të tillë si dhe të distancohen kur bëhen deklarata të tilla.
3. Rekomandimet e organizatës për anëtarët e saj që mund të çojnë në një sjellje uniforme nga anëtarët e saj qoftë edhe kur nuk janë detyruese mund të përbëjnë shkelje të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Organizatave e Biznesit, përveç se duhet të tregohen të kujdesshme për të mos u përfshirë në shkeljet e konkurrencës duhet të kenë një rol aktiv që të nxisin bizneset anëtarë që të njohin dhe zbatojnë rregullat e konkurrencës, në mënyrë që jo vetëm të parandalojnë gjobat nga Autoriteti i Konkurrencës, por edhe të sigurojnë një mjedis biznesi konkurrues i cili është një përfitim të të gjithë aktorëve të tregut, konsumatorëve dhe vetë ndërmarrjeve.